



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2613, datë 10.09.2015

Për

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Anila | Denaj | Anëtar |
| 4. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.09.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit””

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative”;
2. Neni 7, pika 3, germa e), neni 8, germa i), neni 80 dhe neni 110 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 ”Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim Ligji 9918);
3. Rregullore Nr.10 për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 932 datë 11.08.2009, e ndryshuar me VKD nr. 2394, datë 05. 12. 2013;
4. Urdher Nr.1464 date 18.05.2015 për ngritjen e grupit të punës per pergatitjen e dokumenteve per rishikimin e Planit Kombetar te Numeracionit.

5. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi dokumentin për këshillim publik “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” ;
2. Dokumenti për këshillim publik “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit”;
3. Projektvendimi përkatës, si dhe diskutimet në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e :

1. Dokumenti për këshillim publik “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.
Hartimi i dokumentit është bazuar në nenin 7, pika 3, germa e), nenin 8, germa i), nenin 80 dhe nenin 110 të Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 ”Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

Qëllimi rregullator mbi “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” është që ti përgjigjet:

- ndryshimeve të mëdha demografike që kanë ndodhur në Shqipëri dekadën e fundit veçanërisht rritja e madhe e popullimit të zonave urbane si Tirana, Durrësi etj.
- reflektimit të ndikimeve në PKN të migrimit të rrjeteve TDM në rrjetet NGN;
- ndryshimeve në menyren e organizmit të pushtetit vendor dhe ndarjeve administrative.
- heqjes së elementit distance dhe rajon në tarifen e interkoneksionit.

dhe për të bërë mundur:

- rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve të numeracionit si burime të fundme,
- ofrimin e portabilitetit të numrit në një zonë me të gjere nga operatorët, duke zvogeluar barrën administrative për biznesin,
- zvogelimin e barrierave për hyrjet e reja në treg veçanërisht në ato të telefonisë.

Si dhe të krijojë një kuptim më të qartë për impaktin që do të kenë ndryshimet në PKN ;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr.8485 dt 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”;
2. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për ”Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 7, pika 3, germa e), neni 8, germa i), neni 80, neni 110, neni 114 dhe neni 115 ,

3. Rregullore për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 932 datë 11.08.2009, e ndryshuar me VKD nr. 2394, datë 05. 12. 2013;
4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

V E N D O S:

1. Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Ndryshime në Planin Kombëtar të Numeracionit” sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Periudha e këshillimit publik do të jetë 40 ditë nga dita e publikimit zyrtar të këtij dokumenti në faqen e internetit të AKEP.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____